

VENDIM
Nr. 169, datë 26.3.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 88, DATË 30.1.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE
ANSAMBLIT POPULLOR, TË OBJEKTIT NR. 2, PJESË E PRONËS NR. 90, ME EMËRTIM
“SHTABI I KML-SË”, DHE TË OBJEKTEVE NR. 21 E NR. 35, PJESË E PRONËS NR. 84, ME
EMËRTIM “ISH-REGJIMENTI I KIMISË”, ME VENDNDODHJE NË TUFINË, TIRANË, NË
ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

Në vendimin nr. 88, datë 30.1.2013 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e projektvendimit fjalët “... dhe të objekteve nr. 21 e nr. 35, pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë ...”, shfuqizohen.

2. Në pikën 1 të vendimit, fjalët “...dhe të objekteve nr. 21 e nr. 35, me sipërfaqe 1187 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama